



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e komitetit për komunitete e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **09.09.2022** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i komitetit për komunitete **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të komitetit për komunitete, nënkryetarin z. Fatmir Iska, zyrtaren për shëndetësi zonjën Shemsie Deliu, përfaqësues të OSBE-së – UNMIK-ut, përshëndes anëtarët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Ky është takimi i katërt për vitin 2022, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

- 1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë rreth vaksinimit të fëmijëve të komunitetit joshumicë në komunën e Rahovecit;**
- 3. Informatë nga zyra për komunitete dhe kthim;**
- 4. Të ndryshme;**

Kryesuesi – E vendosim në votim rendin e ditës. Kush është “për”?... Atëherë në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës për sot. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës;

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;

Ndonjë gjë shtesë nga ju rreth procesverbalit?... Atëherë vazhdojmë për aprovim të procesverbalit, kush është për?... kundër?...abstenim?... Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali. Pika e radhës;

2. Informatë rreth vaksinimit të fëmijëve të komunitetit joshumicë në komunën e Rahovecit;

Shemsie Deliu – Faleminderit, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Lidhur me informatën rreth vaksinimit të komunitetit Romë, Ashkalinjë, Egjiptas kemi një raport 6 mujor; Ky raport është i përfshirë në një faqe totale dhe fëmijët e vaksinuar i kemi të ndarë në moshë; 0-11 muaj është 18 të vaksinuar. 12-23 muaj / 19 të vaksinuar, 24-59 muaj / 11 të vaksinuar. Raporti korrik-gusht; moshë 0-11 muaj / 2 të vaksinuar, moshë; 12-23 muaj / 2. Raporti i muajit gusht; nga 0-11 muaj / 2 të vaksinuar dhe kaq, nuk ka më të vaksinuar por mendoj që ne si komunë qëndrojmë mirë me numrin e të vaksinuarve të komunitetit Romë, Ashkalinjë, Egjiptas, por edhe në përgjithësi.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë, zonja Shemsie n’a informoj për të vaksinuarit të komunitetit Romë, Ashkalinjë, Egjiptas, pak ishte raport i mangët, nëse ka të dhëna të na informoj në përqindje sa janë të vaksinuar dhe sa janë të pavaksinuar, si qëndron gjendja?...

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, dëshiroj t’a falënderoj zyrtaren Shemsijen, faleminderit për informatën, mundësisht të na dërgoj në mënyrë elektronike statistikat.

Shemsie Deliu – Po patjetër që këto statistika do t’i keni nëpër email-a.

Edona Kryeziu – Mirënjohës dhe përshëndetje për të gjithë, faleminderit për prezencën z. Nënkrjetar të nderuar kolegë asambleist. Zonja Shemsie, faleminderit për informatën edhe pse mendoj që ishte goxha e mangët dhe në bazë statistikave që na dhe mendoj që është një numër shumë i vogël i vaksinimit, a nuk janë të informuar prindërit për këtë gjë, apo është diçka tjetër?...

Lendrit Qeli – Falënderoj shumë zytaren, ndoshta veç një korrigjim të vogël; kur the RAE duhet të thuhet Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë, sepse kushtetuta i njeh ashtu dhe nuk guxojmë të lëshohemi me të përgjithshëm, e dijmë që është gabim teknik, nuk është se na nuk e kemi luftuar prej fillimit. Sa i përket informatës më gjerësisht në këtë fushë, zyra komunale për komunitete dhe kthim në bashkëpunim me organizatën “Ballkan Sunflowers” dhe organizatën ndërkombëtare UNICEF ka një marrëveshje me të cilën është duke bërë ngjitje të vetëdijes për pjesëtarët e komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë për vaksinimin e fëmijëve dhe ne për këtë e kemi angazhuar një tutorë nga radhët e komunitetit Egjiptianë e cila në lagjen e epërme vazhdimisht e përcjell pothuajse në çdo shtëpi të komunitetit kalendarin e vaksinimit dhe të njëjtën kohë përveç që e bën informatën që kur të vie koha për të vaksinuar fëmijët, e ka edhe një mision tjetër për organizimin e aktiviteteve të ndryshme që ka të bëjë në zhvillimin e procesit në fushën e mjeksisë, ngritje të vetëdijes në kuptimin e sëmundjeve të ndryshme, pra disa programe që organizohen në bashkëpunim edhe me QKMF-në këtu në Rahovec.

Kryesuesi – Faleminderit, nëse dikush dëshiron t’a marr fjalën lidhur me këtë pikë?... Atëherë kalojmë në pikën e tretë;

3. Informatë nga zyra për komunitete dhe kthim;

Lendrit Qeli – I nderuar nënkryetar, të pranishëm. Më lejoni që në emër të zyrës për komunitete dhe kthim në pika të shkurta të ju njoftoj për disa aktivitete që është duke i zhvilluar zyra jonë.

Pavarësisht që jemi në një situatë greve, ne si zyrë jemi duke punuar për shkak të nevojave të komuniteteve dhe besoj që e arsyetojmë punën për shkak gjendjes së tyre sensitive. Kryesisht është angazhimi i fundit që jemi duke e bërë si zyrë, është plani 3 vjeçar i banimit social 2022-2024, pavarësisht që ne si zyrë nuk jemi bartës kryesor të këtij dokumenti, meqenëse bashkëpunimi ka rrjedhë prej organizatës “Voice of Rome, Ashkalinje, Egyptians” dhe komunës së Rahovecit, ne si zyrë e kemi marr kryesimin e përgatitjes së këtij dokumenti bashkë me ekspertizën e jashtme si donacion nga organizata në fjalë e cila besoj që do t’a bëjë përmirësimin e situatës së banorëve të komunës tonë sidomos atyre që kanë të bëjnë me banim social. Janë paraparë rreth 50 banesa në kuptimin e mbështetjes për pjesëtarët në nevojë e që për momentin komuna e Rahovecit i ka 18 njësi pothuajse në prag të rregullimit dhe shpresojmë që deri në fund të vitit do të jenë të gatshme, për të tjera do të shohim me mundësi të mbështetjes nga programe të ndryshme. Si pike e dytë që zyra është duke u marrë me tenderimin – renovimin e shtëpive, kjo është një informatë që e kemi bërë edhe herën e kaluar, fatkeqsisht kësaj radhe ky tenderim ka dështuar në mungesë të aplikimit të kompanive dhe e kemi hapur tenderin e dytë bashkë me zyrën e prokurimit dhe shpresojmë që rreth datës 15/16 do të kemi mundësi të bëjmë hapjen e zarfave të atyre që konkurojnë, shpresojmë që të mos dështoj përsëri sepse jemi në një periudhë që po i afrohem vjeshtës në mënyrë që mos të kemi pengesa në realizim të projektit. Meqenëse e diskutuam pak çështjen e vaksinimit më lejoni që të potencoj që e kemi një bashkëpunim me organizatën “Ballkan Sunflowers” dhe UNICEF në Kosovë, ka qenë një projekt-vazhdimësi nga komunat të tjera dhe për mua është fat i mirë që kemi arritur t’a bindim donatorin që për herë të parë të vie edhe në komunën e Rahovecit me një program të tillë dhe shpresojmë që do të vazhdojmë edhe vitin tjetër. Fatkeqsisht gjendja, vetëdija e ulët dhe mentaliteti për t’i vaksinuar pjesëtarët e komuniteteve ka ndikuar që numri të jetë pak më i vogël në gjithë republikën e Kosovës, përfshirë këtu edhe komunën e Rahovecit prandaj këtu organizata janë angazhuar për ngritje të vetëdijes për pjesëtarët e komuniteteve në fjalë. Projekti i fundit i zyrës së komuniteteve për këtë vit, janë dy aplikime që i kemi bërë në zyrën e

kryeministrit, njeri do të jetë për qendrën e komuniteteve në lagjen e epërme, do të jetë me destinacion në shkollë, kam insistuar të jetë në shkollë për shkak të qëndrueshmërisë sepse zakonisht këto qendra janë menaxhuar prej OJQ-ve por në mungesë të mbështetjes, pas një viti qendra është dashur të mbyllet dhe efektshmëria nuk ka qenë në nivel të duhur. Kështu që të jetë me bazë në shkollë do të jetë shumë më i qëndrueshëm si projekt duke marrur parasysh udhëzimin administrativ për mbështetjen e qendrave që bëhet nga ministria e arsimit. Projekti tjetër që është dorëzuar në zyrë për çështje të komuniteteve ka të bëjë me vazhdimin e mundësisë së renovimit të shtëpive, kemi kërkuar një buxhet pak më të madh sepse po e shohim se dështimi i tenderimit të fundit është mosinteresi i firmave për shkak të ngritjes së madhe të çmimeve. Shpresojmë që me mbështetjen tjetër të zyrës së kryeministrit duke e rritur fondin për mbështetje do të përfshihet edhe një numër më i madh i personave në nevojë dhe besoj që me projektin e planifikuar do t'ia dalim. Faleminderit ...

Kryesuesi – Meqë jemi në pikën e tretë, dëshiron t'a marrë dikush fjalën?...

Shemsie Deliu – Nëse ka mundësi, unë duhet të shkoj. Herave tjera do të përpiqem t'iu siguroj të dhëna më të hollësishme lidhur me vaksinimin.

4. Të ndryshme;

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë, udhëheqësinë dhe ti gjithë anëtarët pjesëmarrës. Në fillim të mbledhjes deshta të them atë që do të t'a them tani. Staf i komunal dhe të gjithë anëtarët këtu janë në dijeni lidhur me disa mbrojtëse anësore të një ure në të cilën kalon prroni Lugë-Xërxe, kanë qenë mirë më herët, por janë shpëputur. Kam kërkuar që ato të rivendosen sepse lëvizja e nxënësve dhe kalimtarëve rrezikohet në atë pjesë. Drejtori i shërbimeve publike është i njoftuar, ai e ka lëshuar një vendim ca kohe, realizim dhe interesim për moment nuk ka.

Dushan Stojanoviç – Përshëndetje për të pranishmit. Dy pyetje për shefin e zyrës për komunitete dhe kthim; E para ka të bëjë me çështjen e kërkesës e cila është dërguar për vendosjen e pengesave në rrugë (policëve të shtrirë), pasi që është bërë riparimi i rrugës dhe renovimi i saj, kemi mungesë të këtyre pengesave, çështja e dytë ka të bëjë me ndriçimin publik në fshatin Hoçë e Madhe, ndriçimi i vjetër është larguar, mirëpo i riu nuk është vendosur përkundër problemeve me vjedhje.

Lendrit Qeli – Që të dyja pyetjet janë trajtuar në këshillin për siguri në bashkësi (KKS) dhe kanë marrë përgjigje direkt nga kryetari i komunës. E para; ka të bëjë me pengesat në rrugë, që janë kërkuar në lagjen e epërme, atje ku ka intervenuar ministria e administrimit të pushtetit lokal (MAPL) në bashkëpunim me komunën e Rahovecit dhe ditëve në vazhdim edhe kryetari ka premtuar që në momentin e parë që do të jepet mundësia, do të vendosen atje. Sa i përket pyetjes së dytë, me ndriçimin në fshatin Hoçë e Madhe, atje kemi një situatë tjetër ku kompania që është përgjegjëse që të merret me mirëmbajtje, për shkak të ngritjes së çmimeve refuzon të punoj në çdo punë ku e ka përgjegjësinë e mirëmbajtjes. Po pritet që të gjithë të kenë një aneks mbështetje për të gjitha kompanitë që kanë hasur në këto pengesa në të gjitha fushat. Më lejoni t'a bëjë edhe një informatë; ka të bëjë në fushën e arsimit, organizata "REF" në Kosovë, ka bërë një thirrje për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve Romë, ashkalinjë, Egjiptianë që janë në shkollën e mesme, të kenë mundësinë të aplikojnë për bursë, nëse njihni dikë që është në shkollën e mesme, mund t'a drejtoni te ne, ne i ndihmojmë me dokumentacion në mënyrë që të kemi sa më shumë përfitues nga komuna jonë.

Kryesuesi – Faleminderit për informatën z. Lendrit, deshta të kyçem lidhur me aplikimin për bursë, për nxënës e komunitetit Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë. A është kjo vetëm për nxënës apo edhe për studentë?...


Lendrit Qeli – Informata është vetëm për nxënës të shkollave të mesme dhe nëse e shohin aty në aplikim që nuk figuron komuna e Rahovecit, kemi biseduar me organizatën pasi që jem pjesë e regjionit të Gjakovës, nuk do të ketë "telashe" në këtë drejtim. Meqenëse ne e kemi edhe numrin më të vogël prej

të gjitha komunave nëpër shkolla të mesme, besoj që do të keni mirëkuptim dhe kuptohet që nëse nxënësit janë afër kriterëve.

Kryesuesi – Dëshiron edhe dikush tjetër t'a marrë fjalën?... Nëse jo, konstatoj që takimi është i mbyllur, faleminderit për pjesëmarrjen.

Mbledhja përfundoi: 10:45


Procesmbajtësi
Agim Hoti


Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina